

# Statistikat afatshkurtra

## Shërbimet - Tremujori I 2023


**Tiranë, më 19 Qershor 2023:** Treguesit tremujorë mbi shërbimet, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; Transport, Magazinim dhe Postë; Hotele; Bar-Restorante; Informacioni dhe Komunikacioni; Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike dhe Agjenci udhëtimi, në tremujorin e parë 2023, paraqiten si më poshtë:

### Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave

Indekset e treguesve në aktivitetin Tregti, e cila përfshin tregti me shumicë, tregti me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, në tremujorin e parë 2023, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 2,7 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rritje 2,7 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 22,8 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Tregti (%)




### Transport, Magazinim dhe Postë

Indekset e treguesve në aktivitetin Transport, Magazinim dhe Postë, i cili përfshin transportin Hekurudhor të mallrave, Detar, Ajror, Magazinimin dhe aktivitetin Postar, në tremujorin e parë 2023, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 11,2 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rritje 0,5 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 12,4 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022.


**Fig. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Transport, Magazinim dhe Postë (%)**



### Hotele


Indekset e treguesve në aktivitetin Hotele, në tremujorin e parë 2023, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 2,7 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rritje 4,4 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 14,1 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022.

**Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Hotele (%)****Bar, Restorante**

Indekset e treguesve në aktivitetin Bar-Restorante, në tremujorin e parë 2023, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 1,0 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rritje 0,2 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 12,5 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022


**Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Bar-Restorante (%)**

### Informacion dhe Komunikacion

Indekset e treguesve në aktivitetin Informacion dhe Komunikacion, i cili përfshin aktivitetin e Publikimit, Telekomunikacionit si dhe shërbimet e Teknologjisë së Informacionit, në tremujorin e parë 2023, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 11,2 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rritje 14,8 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 29,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022.


**Fig. 5 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Informacion dhe Komunikacion (%)**



### Aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike


Indekset e treguesve në aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike, në tremujorin e parë 2023, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënje 2,6 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rritje 6,8 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 19,3 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022.

**Fig. 6 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Aktivitete Arkitekturë dhe Inxhinierike (%)****Agjenci udhëtimi**

Indekset e treguesve në aktivitetin Agjenci udhëtimi, në tremujorin e parë 2023, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 49,0 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rritje 25,5 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 38,1 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022.

**Fig. 7 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Agjenci udhëtimi (%)**

**Tab. 1 Indeksi i Shitjeve neto në volum, Shërbime (2015=100)**

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.I 2023 (2015=100)	I.23/ I.22 (%)	Tr. I 2023 (2015=100)	I.23/ IV.22 (%)
G	45+46 +47	<i>Tregti</i>	113,5	2,7	131,0	0,27
H	49-53	<i>Transport dhe Magazinim</i>	117,9	-11,2	133,8	-2,5
I	55,1	<i>Hotele</i>	219,3	2,7	354,1	1,7
I	56	<i>Bar-Restorante</i>	161,2	1,0	170,9	-5,2
J	58, 61, 62	<i>Informacioni dhe Komunikacion</i>	121,2	11,2	132,3	5,6
M	71	<i>Aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike</i>	108,0	-2,6	128,8	13,6
N	79	<i>Agjenci udhëtimi</i>	168,8	49,0	232,9	14,7

**Tab. 2 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, Shërbime (2015=100)**

NVE Rev.2			Numri i të punësuarve		Fondi i pagave	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.I 2023 (2015=100)	I.23/ I.22 (%)	Tr.I 2023 (2015=100)	I.23/ I.22 (%)
G	45+46+47	<i>Tregti</i>	119,2	2,7	173,0	22,8
H	49-53	<i>Transport dhe Magazinim</i>	128,5	0,5	171,9	12,4
I	55,1	<i>Hotele</i>	179,7	4,4	289,7	14,1
I	56	<i>Bar-Restorante</i>	137,2	0,2	223,9	12,5
J	58, 61, 62	<i>Informacioni dhe Komunikimi</i>	182,2	14,8	288,7	29,9
M	71	<i>Aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike</i>	148,7	6,8	228,6	19,3
N	79	<i>Agjenci udhëtimi</i>	156,4	25,5	250,8	38,1

# Metodologjia

## Informacion

Në vazhdim të përpjekjeve të përafrimit dhe standardizimit të statistikave afatshkurtra me statistikat evropiane, INSTAT publikon Statistikat Afatshkurtra –Shërbime si më poshtë :

- Indekset duke filluar nga tremujori i parë 2019, do të llogariten me vit bazë 2015=100.
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore e Ndërmarrjeve për vitin 2020, realizuar nga INSTAT.
- Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën Tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë aktivitetin Shërbimi Ushqimor (Bar- Restorante).

## Informacion mbi vrojtimin

**Qëllimi** - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

## Në Shërbime

**Fusha e mbulimit** - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përvèç automjeteve dhe motoçikletave (46), Tregti me pakicë(47)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor: Hotele (55,1) dhe Bar-Restorante (56)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)
- Agjenci udhëtimi (79)

**Modeli** - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

**Mbledhja e informacionit** - Për këtë tremujor janë përdorur burimet administrative dhe intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2015=100. Të dhënët nuk paraqesin vlera absolute.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres, Për të eleminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhibit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

**Ndryshimi vjetor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

**Ndryshimi tremujor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

**Rishikimi** – Indekset mund të rishikohen për disa arsyet: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur, etj.

#### Përkufizimet e treguesve kryesorë

*Shitjeve neto* - Shitjet neto përfshijnë shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes shërbimeve të parëve, duke përashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

*Indeksi i Shitjeve neto* - Objektivi i indeksit të Shitjeve neto është të paraqesë ecurinë e tregut për shërbime, *Numri i të punësuarve* - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuara (përashtuar të vetëpunësuarit me pagesë).

*Indeksi i Numrit të punësuarve* - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuara.

*Paga dhe trajtime* - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërbllimet e trajtimet (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

*Indeksi i fondit të pagave* - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuara, nga njëra periudhë në tjetrën.

**Përshtatja sezonale** në seritë tremujore të Shërbimeve zbatohet duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2 Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2006 - Tremujori I 2023. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme, Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Në metodën multiplikative ekziston një lidhje midis komponentit të trendit, komponentit sezonal dhe komponentit irregular, ku ky i fundit shpjegon ato pjesë të serisë kohore të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë të pazakonshme. Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.